



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr.06

Prishtinë, më 13.12.2017, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Mufera Shinik, Arbërie Nagavci, Adem Mikullovc, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Fidan Rekaliu, Abdyl Salihu, Nezir Çoçaj, Verica Qeraniq dhe Albulena Balaj-Halimaj.

Përfaqësues të ftuar: Kujtim Gashi, ministër i MKRS-së, Samir Hoxha, këshilltar në MKRS, Shyqiri Bytyçi, ministër i MASHT-it dhe Arben Dërmaku, këshilltar në MASHT.

Përfaqësues të tjerë: Albert Krasniqi- KDI, Shefki Kastrati – NDI dhe përfaqësues të medias.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 21.11.2017;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për Buxhet për vitin 2018 për ministritë e linjës;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 21.11.2017;

Procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 21.11.2017, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Buxhet për vitin 2018 për ministritë e linjës;

Kryetari i Komisionit, në fillim të mbledhjes, tha se janë ftuar ministrat e ministrive të linjës për të diskutuar në lidhje me Projektligji për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018.

Ministri Gashi para Komisionit paraqiti planifikimin buxhetor të ministrisë për vitin e ardhshëm, i cili për dallim nga viti paraprak shënon rritje prej 17.4%, duke arritur vlerën e mbi 34 milionë eurove. Në shpenzime kapitale do të ketë rritje të buxhetit për 17% nga viti që po lëmë pas, në një vlerë prej rreth 19.8 milionë euro ose 58% e buxhetit të përgjithshëm të ministrisë, paga dhe mëditje 4.3 milionë ose 13%, mallra dhe shërbime rreth 1.3 milionë apo 4%, subvencione dhe transfere rreth 8 milion ose 24% të buxhetit dhe shpenzime komunale rreth 400 mijë euro apo shprehur në përqindje në 1% të buxhetit.

Ministri, foli edhe për prioritetet strategjike të ministrisë, si: mbështetjen, masivizimin, zhvillimin e sportit cilësor dhe ngritjen e infrastrukturës sportive sipas standardeve ndërkombëtare, përkrahjen dhe ngritjen e kulturës dhe avancimin e diplomacisë kulturore, fuqizimin e rinisë në proceset zhvillimore, kujdesin dhe sigurinë për shëndetin e rinisë, krijimin e mundësive për punësimin e tyre, qasjen e integruar në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, mbrojtjen dhe parandalimin e dëmtimit të saj, planifikimin, projektimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e komplekseve përkujtimore me rëndësi të veçantë dhe themelimin e Inspektoratit të Trashëgimisë së Kosovës, hap të cilin Kosova po e bën për herë të parë.

Teuta Haxhiu, në diskutimin e saj tha se vërehet një rritje e buxhetit në krahasim me vitin paraprak, ndërsa kërkoi sqarim në lidhje me buxhetin e ndarë për investimet e MKRS-së për stadiumin e KF Vllaznimi në Gjakovë si dhe për teatrot e qyteteve të Gjakovës e Gjilanit. Gjithashtu kërkoi sqarim në lidhje me hapat e ndërmarrë nga ministria për projektligjin për vullnetarizëm.

Adem Mikullovci, tha se ministria do të duhej të nxjerr një rregullore për kategorizimin e aktorëve dhe përformuesve, si dhe kërkoi që të hyrat nga shitja e biletave të mbesin në buxhetin e teatrit e jo të shkojnë në ministri.

Arbërie Nagavci, tha se rritja e buxhetit prej 23 % për paga dhe mëditje a nënkupton kjo rritje të numrit të punëtorëve apo keni planifikuar rritje të pagave për punëtorët e teatrit sikurse është

premtuar, ndërsa rritje prej 21 % për shpenzime komunale, çka parashohin këto shpenzime si dhe rritja prej 16% të shpenzimet kapitale që pritet të realizohen nga AKP-ja e që nuk janë të sigurta. Nagavci u interesua në lidhje me projektet e ministrisë për investime në stadiumin e qytetit të Gjakovës dhe teatrin e Gjakovës.

Valentina Bunjaku-Rexhepi, tha se ministria do të duhet të iniciojë ndryshimin e Ligjit për Teatrot, në mënyrë që të përmirësohet pozita e teatrove të qyteteve e sidomos teatrit të Gjilanit dhe atë të Gjakovës. Po ashtu, ajo kërkoi sqarim nga ministri në lidhje me mbështetjen financiare që ka paraparë për Ansamblin "SHOTA", Filarmoninë e Kosovës dhe subvencionimin e klubeve të futbollit të Dritës dhe Gjilanit, që meritojnë një trajtim të veçantë.

Nezir Çoçaj, tha se po vërehet rritje e buxhetit dhe shuma e konsiderueshme do të dedikohet për infrastrukturë sportive, paga e mëditje si dhe rritje të numrit të punëtorëve të ministrisë. Kërkoj sqarim në lidhje me investimet në rini e kulturë, teatro, shoqëri kulturo-artistike si dhe në trashëgimi kulturore.

Fidan Rekaliu, kërkoi sqarim nga ministri në lidhje me strategjinë e veprimit për rini, për qendrat rinore dhe këshillat lokale të veprimit rinor.

Ismajl Kurteshi, tha se vërehet rritje e buxhetit në disa sektorë, ndërsa sa i përket kërkesës së ministrit për rritje të buxhetit për paga dhe mëditje u vërejt planifikimi për rritjen e numrit të punëtorëve të ministrisë dhe kërkoi sqarim rreth rritjes së numrit të punëtorëve .

Ministri Gashi, iu përgjigj anëtarëve të komisionit në çështjet e ngritura në lidhje me projektet e planifikuara dhe ndarjet buxhetore sipas kategorive. Ai tha se me marrjen e mandatit ka formuar grupin punues gjithëpërfshirës për hartimin e Strategjisë për Rini. Ky dokument është në fazën finale dhe presim që gjatë këtij muaji ta kemi të përfunduar.

Sa i përket shoqërive kulturore dhe festivaleve, MKRS ka një bashkëpunim të mirë me komunat dhe në bashkëpunim me to, shpallen konkurset dhe mbështeten me mjete financiare, gjithashtu edhe mbështetjen e aktivitete ad-hoc nëpër komuna të ndryshme. Sa i përket monumenteve të trashëgimisë kulturore, tha se janë gjashtë qendra rajonale të trashëgimisë kulturore dhe të gjitha projektet që mbështet MKRS, kalojnë përmes këtyre qendrave. Lidhur me rritjen e numrit të punëtorëve, tha se kjo kërkesë ka ardhur nga të gjitha departamentet dhe këto pozita janë kryesisht pozita profesionale, që mungojnë në departamente të veçanta. Po ashtu, kjo kërkesë është miratuar në Ministrinë e Financave. MKRS, për herë të parë, tani themelon Inspektoratin e Trashëgimisë Kulturore dhe është shpallur konkursi për zgjedhjen e stafit që do të punojë në këtë inspektorat.

Sa i përket çështjes së ngritur rreth teatrove të qyteteve të Gjilanit e Gjakovës, tha se në takimet që ka pasur me përfaqësues të sindikatave, jemi pajtuar që në vitin 2018 të bëhet ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për teatrot, me qëllim të tejkalimit të vështirësive rreth financimit dhe funksionimit të teatrove. Po ashtu, kërkohet nga komunat që ta marrin parasysh modelin e funksionimit të Teatrit të Prizrenit.

Sa i përket financimit të klubeve sportive, jemi në finalizim të rregullores për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, me qëllim të ndryshimit të formës së financimit. Kjo rregullore kërkon një koordinim me Ministrinë e Financave, për shkak të lehtësirave financiare për bizneset dhe e njëjta pritet të hyjë në fuqi nga janari i vitit 2018.

Sa i përket projekteve kapitale, të parapara përmes fondeve nga buxheti i AKP-së, tha se do të jetë një problem i madh, nëse nuk kalon Ligji për AKP-në, pasi që një numër i madh i projekteve të parapara varet nga ky buxhet. Çështja e rritjes së buxhetit për komunat, është çështje që do zgjidhje, në mënyrë që të bëhet një decentralizim i mjeteve financiare për institucionet e kulturës për këto shërbime.

Ismajl Kurteshi, në vijim tha se do të diskutohet edhe në lidhje me projektbuxhetin e MASHT-it për vitin 2018 dhe fjala iu dha ministrit.

Shyqiri Bytyçi, ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, paraqiti në mënyrë të përgjithshme linjat buxhetore për vitin 2018. Ai tha se ministria që ai drejton, ka një buxhet në rritje, përafërsisht prej 20 % krahasuar me vitin e kaluar. Ai bëri të ditur se buxheti i miratuar në parim për vitin 2018 për sektorët që ai udhëheq, është mbi 54 milionë euro që sipas tij me këtë buxhet të ndarë nga Qeveria, arsimi nuk mund të jetë prioritet as këtë vit.

Arbërie Nagavci, tha se në planifikimin buxhetor për vitin 2018, shihet se është zvogëluar buxheti për trajnim të mësimitdhënësve dhe zhvillim të plan- programit. Pse është marr një vendim i tillë kur dihet se ka nevojë për përmirësimin e cilësisë, sa i përket numrit të punëtorëve, a është paraparë punësimi i stafit mbështetës në shkolla si asistentët e fëmijëve me nevoja të veçanta, psikologët e pedagogët si dhe çka është planifikuar në lidhje me implementimin e kontratës kolektive për pagat jubilarë dhe Ligjin për mësimitdhënësit e viteve të 90-ta.

Teuta Haxhiu, në diskutimin e saj tha se rritja e buxhetit për arsim është një lajm i mirë dhe se duhet të punohet që arsimi të jetë prioritet shtetëror. Ajo që bie në sy është që MASHT-i ka bërë zvogëlim të buxhetit për trajnimin e mësimitdhënësve, në këtë drejtim tha se lidhur me trajnimin e mësimitdhënësve janë dhënë shuma të konsiderueshme të mjeteve ndërsa asnjë herë nuk ka pasur mbikëqyrje apo monitorim të rezultateve të trajnimeve, siç është rasti me trajnimin e ECDL. Çështje tjetër, përmendi Projektligjin për mësimitdhënësit e viteve të 90-ta, punësimin e pedagogëve e psikologëve në shkolla, si dhe ndërtimin e shkollave në fshatrat Ponoshec, Lumbardh, Has si dhe ndërtimi objektit të FSHMN-së.

Mufëra Sinik, ngriti çështjen e mungesës për fletoret e punës në gjuhën e komunitetit turk dhe boshnjak si dhe çështjen e pedagogëve dhe psikologëve. Në ato shkolla ku mësimi zhvillohet në gjuhën turke dhe boshnjake, mungojnë pedagogët dhe psikologët, andaj ajo kërkoi nga ministri një planifikim më të mirë për këtë çështje.

Valentina Bunjaku-Rexhepi, kërkoi sqarim në lidhje me planifikimet buxhetor për vizita studimore për nxënësit dhe studentët e dalluar. Sa i përket psikologëve dhe pedagogëve në shkolla, ajo tha se MASHT-i duhet të shqyrtojë mundësinë e punësimit të tyre. Ajo ngriti çështjen për ndarjen e buxhetit për ndërtimin e Kampusit të Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan duke pasur parasysh se komuna ka ndarë parcelën.

Nezir Çoçaj, tha se bashkëpunëtorët profesionalë si pedagogët e psikologët, janë të domosdoshëm në shkollat tona, rezultatet e testit PISA kanë qenë të dobëta. Nuk pajtohet me zvogëlimin e buxhetit për trajnimin e mësimitdhënësve nga se rezultatet dhe ngitja e cilësisë në arsim varet edhe nga buxheti i ndarë. Ai kërkoi nga ministri që për hulumtime shkencore dhe Institutet hulumtuese të rris buxhetin si dhe angazhohet që universitetet publike të kenë një autonomi financiare për çështje të caktuara. Po ashtu, ai ngriti çështjen e Projektligjit për mësimitdhënësit e viteve të 90-ta.

Albulena Balaj-Halimaj, tha se vërehet rritje e buxhetit për arsim dhe një angazhim i ministrit për të përmirësuar cilësinë në arsim dhe kërkoi sqarim në lidhje me koston buxhetore për testin PISA, strategjinë për përmirësimin e praktikës profesionale në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Ajo ngriti çështjen e fenomenit të braktisjes së shkollës e që sipas saj ministria duhet të merr masa në këtë drejtim.

Fidan Rekaliu, ngriti shqetësimin për vonesën në ndërtimin e Gjimnazit "Aleksandër Xhuvani" në Podujevë, ndërtim ky që ka nisur në vitin 2009, e që ende nuk ka përfunduar edhe pse nga viti në vit ndahet buxhet për këtë shkollë.

Ismajl Kurteshi, tha se meqenëse në disa shkolla mësimi zhvillohet me tre ndërrime, a janë paraparë investime për ndërtimin e shkollave të reja, ndërtimin e çerdheve që planifikohen të ndërtohen gjatë vitit 2018, ndërtimin e objektit të FSHMN-së si dhe përmirësimin e kushteve të punës për Institutin Pedagogjik. Ai ngriti çështjen e obligimeve të ministrisë karshi Kontratës Kolektive, Projektligjin për mësimitdhënësit e viteve të 90-ta si dhe njoftoi ministrin me Rezolutën e miratuar nga Kuvendi i Kosovës, me të cilën obligohet ministri të raportojë çdo tre muaj në Kuvend.

Ministri Bytyçi, iu përgjigj pyetjeve të deputetëve, duke dhënë sqarimet e nevojshme për të gjitha çështjet e ngritura që bien në fushëveprimin e kësaj ministrie.

Lidhur me trajnimin e mësimitdhënësve dhe kurrikulat, tha se është e vërtetë që kemi zvogëlim të buxhetit, për shkak se MASHT, pas analizave rreth shpenzimeve për trajnime, ka konstatuar se nuk janë arsyetuar shpenzimet me cilësinë e trajnimeve, andaj ne do të fokusohemi në formën dhe cilësinë e trajnimeve dhe rritjen e përgjegjësisë, gjë që do të kërkohet ndihmë në trajnimin e mësimitdhënësve nga ana e Fakultetit të Edukimit. Sa i përket pjesës së buxhetit për kurrikula, tha se ka përfunduar pjesa më e madhe e përgatitjes së kurrikulave dhe nuk kërkohet buxhet shtesë. Projektligji për arsimin në vitet 1990/99, me marrjen e mandatit, e kemi marrë me prioritet këtë çështje dhe e kemi proceduar në Qeveri. Është e vërtetë që ka implikime buxhetore dhe nuk dihet kostoja e saktë e këtij ligji dhe për këtë çështje kemi diskutuar edhe me FMN-në dhe shumë shpejt do të procedohet në Kuvend.

Sa i përket çështjes së ndërtimit të shkollave, kemi pranuar shumë kërkesa, por është e pamundur të përfshihen të gjitha me këtë buxhet që kemi dhe jemi duke shikuar edhe forma të tjera se si mund të ndërtojmë këto shkolla, sikurse është rasti me disa kampuse universitare, që të gjitha i kemi kategorizuar në prioritetet për investime sociale. Prioritet i MASHT, është ndërtimi i objekteve shkollore në ato zona ku mësimi zhvillohet aktualisht në tre ndërrime, që jemi edhe duke bashkëpunuar me DKA, për të bërë planifikimet e sakta.

Sa i përket buxhetit për ndërtimin e objektit të FSHMN-së, ne nuk kemi ndarë buxhet për këtë vit, për shkak se po presim nga UP dhe Komuna e Prishtinës, të përcaktohen për lokacionin se ku do të ndërtohet dhe mandej t'i bëjmë edhe ne ndarjet buxhetore.

Sa i përket rezultateve të testit PISA-s, kemi shprehur interesim për tërheqje të përkohshme dhe të shtyhet testi për vitin 2019 dhe përgjigjja që kemi marrë ka qenë negative. Ne kemi formuar tani një grup punues për t'u marrë me çështjen e testit PISA-s. Ky grup punues ka përgatitur një plan dinamik të punës rreth përgatitjeve për organizim më të mirë të testit, që nga informimi me kohë i të gjitha drejtorive, shkollave e nxënësve, si dhe organizimin e dy testeve pilotuese.

Sa i përket librave ndihmës në gjuhët e komuniteteve, kam angazhuar zëvendësministrin për komunitete, për të formuar një komision për identifikimin e probleme, që aktualisht janë dhe për të marrë hapat e nevojshëm për të tejkaluar këtë problematikë.

Gjatë vitit 2018, planifikohen të ndërtohen 11 çerdhe, prej të cilave 3 me buxhet të MASHT-it dhe të tjerat nga fondet e IPA-s.

4. Të ndryshme.

Ismajl Kurteshi, diskutoi në lidhje me shkresën Ex Officio 894/2016, për zbatimin e rekomandimeve të dala nga Raporti për të Drejtat në Shëndetin Seksual dhe Riprodhues në Kosovë. Ai tha se rekomandimet e dala nga ky Raport, janë realizuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit, me përkrahjen e UNFPA-s dhe u janë përcjellë autoriteteve përgjegjëse vitin e kaluar, por raportimi rreth zbatimit të tyre nuk ka ndodh tek Avokati i Popullit.

Komisioni me këtë rast kërkoi nga ministri i MASHT-it z.Shyqiri Bytyçi, ndërmarrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të dala nga ky raport dhe raportimin tek Avokati i Popullit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:15.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit

Kryetari i komisionit,

Ismajl Kurteshi